



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 24 korrik 2024  
Nr. ref.: MPM 2493/24

**MENDIM I PËRBASHKËT MOSPAJTUES**  
i gjyqtarëve Remzije Istrefi-Peci, Enver Peci dhe Jeton Bytyqi

në

**rastin nr. KI172/23**

Parashtrues

**Rejhane Ceka  
Fiknete Ceka  
Lejlane Ceka  
Sara Ceka**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Rev. nr. 216/2023, të 19 qershorit 2023, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së  
Apelit të Kosovës,  
Ac. nr. 3023/2020, të 7 prillit 2023**

E respektojmë vendimin e Shumicës së Gjyqtarëve (në tekstin e mëtejshëm: Shumica) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata). Pajtohemi me Shumicën që kërkesa është e pranueshme, megjithatë, gjithnjë me respekt, kemi votuar kundër konstatimit të shkëljes së paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ). Prandaj, për arsyet që do të elaborohen në vijim dhe bazuar në rregullin 56 (Mendimet mospajtuese) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës), paraqesim këtë Mendim mospajtuës.

**Fushëveprimi i kërkesës**

- Parashtrueset e kërkesës kontestojnë Aktvendimin [Rev.nr.216/2023] e 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 3023/2020] e 7 prillit 2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C. nr. 237/18] e 13 dhjetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Ferizaj – dega Kaçanik (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore).

2. Parashtrueset e kërkesës konsiderojnë se vendimet e lartcekura u kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], si dhe paragrafët 3 dhe 5 të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës.
3. Shumica vendosi (i) të konstatojë se ka pasur shkelje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së; (ii) ta shpallë të pavlefshëm Aktvendimin [Rev. nr. 216/2023] e 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës; dhe (iii) ta kthejë Aktvendimin [Rev.nr.216/2023] e 19 qershorit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës në rivendosje, pranë kësaj të fundit.

### **Faktet e rastit dhe pretendimet e parashtrueseve**

4. Faktet e rastit, ashtu siç janë të reflektuara edhe në Aktgjykim në rastin KI172/23, ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës dhe të prindërve të tyre, kundër kompanisë së sigurimeve “Elsig Sh.A.” (në tekstin e mëtejme: kompania e sigurimeve), për kompensim të dëmit material dhe jo-material për shkak të vdekjes së vëllait të tyre në aksident komunikacioni.
5. Gjykata Themelore kishte aprovuar kërkesëpadinë e parashtrueseve të kërkesës si dhe të prindërve të tyre sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jo-material, ku për dëmin jo-material, parashtrueseve të kërkesës i’u akordua veç e veç shuma në lartësi prej 8,000 (tetë mijë) euro secilës, ndërsa secilit prind në lartësi prej 10,000 (dhjetë mijë) euro. Pas ankesës së kompanisë së sigurimit, Gjykata e Apelit ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në raport me parashtrueset e kërkesës, duke zbritur shumën nga 8,000 (tetë mijë) euro në 5,000 (pesë mijë) euro për secilën nga parashtrueset e kërkesës. Si pasojë, parashtrueset e kërkesës parashtruan revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit për kompensim të dëmit duke u thirrur në zbatimin e gabuar të dispozitave të së drejtës materiale. Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.216/2023] të 19 qershorit 2023, e hodhi poshtë revizionin si të palejuar pasi konstatoi se (i) bazuar në nenin 268 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejmes: LPK), parashtrueset e kërkesës janë bashkëndërgjyqëse të thjeshta, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë, andaj, edhe vlera e kontestit merret veç e veç për secilën prej tyre; dhe si pasojë; (ii) duke qenë se vlera e kontestit nuk kalonte shumën prej 3,000 (tremijë) euro për secilën prej tyre, bazuar në paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së, revizioni i tyre është i palejuar.
6. Para Gjykatës, parashtrueset e kërkesës pretendojnë shkelje (i) të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) të së drejtës për mjete juridike të garantuar me nenin 32 të Kushtetutës; dhe (iii) të së drejtës për mbrojtje gjyqësore të të drejtave të garantuar me nenin 54 të Kushtetutës, si dhe (iv) paragrafëve 3 dhe 5 të nenit 102 të Kushtetutës, ndër të tjera, pasi sipas tyre vlera e objektit të kontestit të tyre e kalon vlerën prej 3,000 (tremijë) euro me arsyetimin që kërkesat e tyre nuk janë konteste të ndara por përbëjnë një kërkesë të vetme, sepse (i) mbështeten në të njëjtën bazë juridike dhe faktike dhe (ii) ndërlidhen me një të paditur; si dhe (iii) përmbajnë kërkesa të njëjta për të gjithë paditësit.

## Vërejtje preliminare

7. Siç u theksua më lart, Shumica ka konstatuar se vendimet e kontestuarra janë nxjerrë në shkëlqje të paragrafit 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, me arsyetimin se Gjykata Supreme ka shkëlqur parimin e “*qasjes në gjykatë*” pasi e njëjta nuk ka vendosur për revizionin e parashtruar kundër Aktgjykimit me të cilin ishte zvogëluar shuma e kompensimit nga 8,000 (tetëmijë) euro në 5,000 (pesëmijë) euro për secilën nga parashtrueset e kërkesës veç e veç, por ka hedhur poshtë revizionin si të palejuar për shkak se vlera e përcaktuar në Aktgjykimin e goditur të Gjykatës së Apelit përmes revizionit, nga secila nga parashtrueset, nuk e ka kaluar shumën prej tremijë (3,000) euro, si kusht për të paraqitur revizion bazuar në nenin 211 të LPK-së.
8. Lidhur me këtë, për Shumicën, nuk ka qenë kontestuese që (i) vlera e goditur përmes revizionit nga secila nga parashtrueset e kërkesës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit është nën vlerën prej tremijë (3,000) euro; kontestuese, sipas Shumicës, në rrethanat e rastit konkret, përfshirë dhe bazuar në pretendimet e parashtrueseve të kërkesës, është (ii) nëse vlera e kontestit prej më tepër se 3,000 (tremijë) euro si kusht ligjor për paraqitjen e revizionit, duhet të jetë vlerësuar nga Gjykata Supreme veç e veç për secilën nga parashtrueset, apo (iii) marrë parasysh rrethanat specifike të rastit, vlera do të duhej vlerësuar në tërësinë e saj për të gjitha parashtrueset, përkatësisht në vlerën prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro.
9. Shumica ka arsyetuar, në esencë se, në rrethanat e rastit konkret, ishte detyrë primare e Gjykatës Supreme që dispozitat relevante të LPK-së t'i shtjellojë dhe aplikojë në tërësinë e tyre dhe jo në mënyrë të izoluar. Më saktësisht, aplikimi i nenit 211 të LPK-së që përcakton shumën prej mbi 3,000 (tremijë) euro si kusht për paraqitjen e revizionit, në ndërlidhje me nenin 268 të LPK-së që përcakton se secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkon në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë, ndërsa në anën tjetër anashkalimi i plotë i nenit 32 të LPK-së që përcakton se në qoftë se në një padi të ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështeten në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave, përderisa aplikimi dhe/ose mos aplikimin i nenit 32 të LPK-së ishte vendimtar për të përmbushur aspektin *ratione valoris* për paraqitjen e revizionit, dhe nëse kjo ka rezultuar në “*formalizëm i tepruar*” në interpretimin dhe zbatimin e ligjit në kontekst të së drejtë për “*qasje në drejtësi*”, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së.
10. Me respekt ndaj Shumicës, nuk mund të pajtohem me konstatimet e lartcekura, pasi që konsiderojmë se këto konstatime nuk janë në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së.

## **Përkritazi me kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës [Rev.nr.216/2023], të 19 qershorit 2023**

11. Fillimisht, ashtu siç është theksuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, çështja e hedhjes poshtë të revizionit, për shkak se i njëjti nuk e arrin vlerën e përcaktuar me ligj, hyn në kuadër të së drejtës për “*qasje në gjykatë*”, si pjesë përbërëse e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e Gjykatës, [KI96/22](#), parashtrues *Naser Husaj dhe Uljks Husaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 gushtit 2023, paragrafi 49). Prandaj, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, e “*drejta në gjykatë*” përcakton që palët

në procedurë duhet të kenë një mjet efektiv juridik që ua mundëson atyre mbrojtjen e të drejtave të tyre civile (shih rastet e lartcekura të Gjykatës [KI54/21](#), me parashtruesin e lartpërmendur *Kamber Hoxha*, paragrafi 62; [KI224/19](#), me parashtruesin e lartpërmendur *Islam Krasniqi*, paragrafi 35; dhe [KI20/21](#), me parashtruesin e lartcekur *Violeta Todorović*, paragrafi 41, shih në këtë kontekst dhe rastet e lartcekura të GJEDNJ-së, [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), paragrafi 49, dhe rastin e lartcekur [Naït-Liman kundër Zvicrës](#), paragrafi 112).

12. Megjithatë, e drejta për “*qasje në gjykatë*” nuk është absolute, por mund t’i nënshtrohet kufizimeve, pasi që nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë drejtim (shih në lidhje me këtë rastin e lartcekur të Gjykatës [KI54/21](#), paragrafi 64; [KI20/21](#), cituar më lart, paragrafi 44). Në këtë kontest, çdo kufizim i të drejtës së qasjes në gjykatë nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të dëmtohet vetë thelbi i “*së drejtës në gjykatë*”. Kufizimet e tilla nuk do të jenë të pajtueshme nëse ato nuk ndjekin një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih rastin e lartcekur të Gjykatës [KI 20/21](#), cituar më lart, paragrafi 45, dhe rastet e GJEDNJ-së: [Sotiris dhe Nikos Koutras ATTEE kundër Greqisë](#), Aktgjykim i 16 nëntorit 2000, paragrafi 15, dhe [Bëlesh dhe të tjerët kundër Republikës Çeke](#), Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 61).
13. Në këtë kontekst, dhe më specifikisht ndërlidhur me prapun ligjor *ratione valoris*, GJEDNJ, përmes praktikës së saj gjyqësore, ka theksuar se kjo e fundit “*ka pranuar më tej se aplikimi i një prapun ligjor ratione valoris për ankesat në gjykatën supreme është një kërkesë procedurale legjitime dhe e arsyeshme duke pasur parasysh thelbin e rolit të gjykatës supreme për t’u marrë vetëm me çështje të rëndësisë së nevojshme*” (shih rastin e GJEDNJ-së [Zubac Kundër Koracisë](#) nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 83, dhe rastet e cituara aty).
14. Gjithashtu, GJEDNJ ka sqaruar se “*bazuar në praktikën në lidhje me zbatimin e kufizimeve ligjore ratione valoris për qasje në gjykatat e larta, Gjykata duhet në shkallë të ndryshme të marrë parasysh disa faktorë të mëtejshëm, përkatësisht (i) parashikueshmërinë e kufizimit, (ii) nëse është parashtruesi i kërkesës ose shteti i paditur ai i cili duhet të bartë pasojat negative të gabimeve të bëra gjatë procedurës që çuan në mohimin e qasjes së parashtrueses së kërkesës në gjykatën supreme dhe (iii) nëse mund të thuhet se kufizimet në fjalë përfshijnë “formalizëm të tepruar”* (shih, rastin [Zubac kundër Kroacisë](#), paragrafi 85, dhe rastet e cituara aty).
15. Në këtë aspekt, dhe më specifikisht sa i përket parashikueshmërisë së kufizimit, GJEDNJ ka theksuar se një praktikë koherente gjyqësore e brendshme dhe një zbatim i qëndrueshëm i kësaj praktike normalisht do të plotësojë kriterin e parashikueshmërisë në lidhje me një kufizim të qasjes në gjykatën e lartë (shih, rastet e GJEDNJ-së [Jovanović kundër Serbisë](#), cituar më lart, paragrafi 48, dhe [Egić kundër Kroacisë](#), cituar më lart, paragrafët 49 dhe 57).
16. Prandaj, siç rezulton nga parimet e GJEDNJ-së, në parim, kushtëzimi i një mjeti juridik në nivel të Gjykatës Supreme me një vlerë të caktuar, nga pikëpamja e të drejtës për një gjykim të drejtë është i lejuar dhe legjitim duke pasur parasysh edhe thelbin e rolit të gjykatave më të larta për t’u marrë vetëm me çështje të rëndësisë së nevojshme, dhe duhet të plotësojë kriteret e lartcekura të përcaktuara në praktikë gjyqësore të GJEDNJ-së.
17. Në rastin konkret, Gjykata Supreme, përmes vendimit të kontestuar, kishte vendosur që revizioni i parashtrueseve të kërkesës është i palejuar me arsyetimin se vlera e

kontestit e secilës parashtruese veç e veç, bazuar në bashkëndërgjyësinë e thjeshtë, nuk kalonte shumë prej 3,000 (tremijë) euro. Gjykata Supreme e kishte bazuar vendimin e saj në paragrafin 2 të nenit 211 që përcakton se “*Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesat në të holla, [...] po që se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro*”, dhe nenin 268 të LPK-së sipas së cilit: “*Secili bashkëndërgjyqës në procesin kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkojnë në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë.*”

18. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme kishte arsyetuar se: [...] dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së revizionit e kushtëzuar me vlerën e kontestit e cila duhet të jetë mbi 3,000 (tre mijë) euro, për të qenë i lejuar revizioni, dhe situatës kur revizioni lejohet pavarësisht vlerës së kontestit sipas kriterit përjashtues për natyrën e çështjes kontestuese. Në këtë rast vlera e kontestit në pjesën e refuzuar nga gjykata e shkallës së dytë për paditësit për secilën kërkesë veç e veç të tyre është dhe atë: paditëses [R.C], motra e të ndjerit në shumë prej 3,000 €, paditëses [F.C], motra e të ndjerit në shumë prej 3,000 €, paditëses [L.C], motra e të ndjerit në shumë prej 3,000 €, paditëses [S.C.], motra e të ndjerit në shumë prej 3,000 €, e që nuk e kalon shumë prej 3,000 € për asnjërin prej paditësve. Në këtë çështje kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqës të thjeshtë, ku pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve tjerë. Në bazë të nenit 268 të LPK-së, çdo njeri nga këta është i pavarur në gjykim dhe se vlera e kontestit merret veç e veç për çdo njeri prej tyre”.
19. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme, duke vlerësuar se (i) secili bashkëndërgjyqës në këtë proces kontestimor është palë në vete dhe kryerja apo moskryerja e veprimeve të tilla procedurale, as nuk i shkon në favor e as në dëm bashkëndërgjyqësve të tjerë; kishte vlerësuar se (ii) asnjëra nga parashtrueset e kërkesës nuk kishte kaluar pragun prej 3,000 (tremijë) eurove, siç përcaktohet në nenin 211 të LPK-së.
20. Bazuar në si më lart, konsiderojmë se ky konstatim i Gjykatës Supreme është në harmoni me praktikën tashmë të konsoliduar të Gjykatë Kushtetuese në një numër rastesh para saj kur kishte vlerësuar përkitazi me çështjen e lejueshmërisë së revizionit para Gjykatës Supreme si rezultat i mos përmbushjes së pragut të vlerës së kontestit. Në këtë kontekst, i referohemi rastit të Gjykatës [KI199/18](#), Aktvendim për papranueshmëri i 6 qershorit 2019, përkatësisht paragrafit 38, ku Gjykata ka theksuar se “*Praktika gjyqësore e kësaj Gjykate tregon se ka pasur edhe raste të tjera kur është kontestuar një aktvendim i Gjykatës Supreme – sikurse ky i tanishmi - përmes së cilit ish-in refuzuar si të palejuara kërkesat për revizion në të cilat vlera e kontestit ishte nën 3,000 euro. Në rastet e tilla Gjykata, sikurse në rastin e tanishëm, është fokusuar vetëm në atë se, në tërësi, a kanë përfituar parashtruesit përkatës nga një gjykim i drejtë dhe i paanshëm duke mos u lëshuar në çështje të ligjshmërisë dhe aspekteve të interpretimit të ligjit procedural dhe material duke qenë se ingjencat e tilla janë nën juridiksionin primar të gjykatave të rregullta. Rastet e tilla, Gjykata i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara. (Shih, rastet e Gjykatës Kushtetuese ku është kontestuar një vendim i Gjykatës Supreme që kërkesën për revizion e ka refuzuar në baza procedurale si të palejueshëm: [KI66/18](#) parashtrues Sahit Muçolli, Aktvendim i 6 dhjetorit 2018; [KI110/16](#) parashtrues Nebojsa Dokić, Aktvendim i 24 marsit 2017; [KI24/16](#) parashtrues Avdi Haziri, Aktvendim i 4 nëntorit 2016; [KI112/14](#) parashtrues Srboľjub Krstić, Aktvendim i 19 janarit 2015; [KI84/13](#) parashtrues Gani, Ahmet dhe Nazmije Sopaj, Aktvendim i 18 nëntorit 2013).”*
21. Shumica, bazuar edhe në parimet e përgjithshme të elaboruara më lart, nuk e ka vënë në pikëpyetje faktin që (i) asnjëra nga parashtrueset e kërkesës nuk e kalon vlerën prej

3,000 (tremijë) euro të përcaktuar me ligj; (ii) që dispozita ligjore e cila përcakton pragun ligjor *ratione valoris* para Gjykatës Supreme ndjek një qëllim legjitim, përkatësisht respektimin e sundimit të ligjit dhe administrimin e duhur të drejtësisë. Po ashtu në kuadër të (iii) proporcionalitetit të kufizimit nuk ka qenë kontestuese për shumicën që (a) procedura për paraqitjen e revizionit është e rregulluar në një mënyrë koherente dhe të parashikueshme në ligjin e aplikueshëm; dhe (b) kufizimi nuk ka qenë rezultat i gabimeve të bëra gjatë procedurës qoftë nga gjykatat ose nga parashtrueset e kërkesës. Kontestuese për Shumicën ka qenë vetëm nëse në interpretimin e ligjit të aplikueshëm (c) ka pasur *“formalizëm të tepruar”* nga ana e Gjykatës Supreme dhe atë për faktin se Gjykata Supreme nuk i'u referua dhe as nuk sqaroi dispozitën e LPK-së, përkatësisht nenin 32 të saj, dhe e cila ndërlihet me mënyrën e përcaktimit të vlerës së përgjithshme të objektit të kontestit.

22. Lidhur me këtë, i referohemi nenit 32 të LPK që përcakton se (i) në qoftë se në një padi të ngritur kundër një të padituri përfshihen disa kërkesa që mbështetën në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave; dhe (ii) në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë ngritur kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç. Megjithatë, neni 32 i LPK-së i referohet objektit të kontestit përkitazi me padinë dhe e rregullon këtë të fundit në rastet kur e njëjta ngritet (i) kundër një të padituri, ndërsa neni 32 i LPK-së (ii) është i heshtur në raport me rastet kur kemi të bëjmë me më shumë se një paditës, siç është rasti konkret. Gjithashtu, neni 32 i LPK-së (iii) nuk e rregullon mënyrën e llogaritjes së vlerës së revizionit, e cila sipas nenit 211 të LPK-së, ka të bëjë me vlerën e goditur përmes revizionit dhe jo me vlerën e përgjithshme të kontestit të përcaktuar sipas nenit 32 të LPK-së. Në ndërlihdje me këtë dhe në rrethanat e rastit konkret, vërejmë që edhe gjykatat e rregullta për të gjithë paditësit kishin vendos veç e veç, rrjedhimisht për babanë dhe nënën e të ndjerit shuma e kompensimit të dëmit material dhe jo material të caktuar nga gjykatat ka qenë më e lartë, ndërsa për secilën nga motrat shumen më të ulët dhe në këtë aspekt gjykatat kanë qenë në pamundësi të akordojnë një shumë unike për të gjithë paditësit.
23. Andaj, në këto rrethana konsiderojmë se Gjykata Supreme ka vlerësuar shumën e revizionit bazuar në nenin 268 të LPK-së sa i përket bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë, ku secili bashkëndërgjyqës është palë në vete, ndërsa vlera e përbashkët e goditur në revizion do të vinte në shprehje vetëm nëse do të aplikoheshin neni 269 i LPK-së që përcakton se *“Në qoftë se sipas ligjit ose për shkak të natyrës së raportit juridik kontesti mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve (bashkëndërgjyqësia unike), atëherë ata të gjithë konsiderohen si një palë ndërgjyqëse e vetme”*. Në rrethanat e rastit konkret, ky nuk ishte rasti pasi, pavarësisht që kontesti ndërlihdhej me të njëjtën bazë faktike dhe juridike, secila nga parashtrueset e kërkesës kishte paraqitur revizionin për kompensim të dëmit përkitazi me shumën e akorduara për to nga Gjykata e Apelit dhe si pasojë do të barte pasojat përkitazi me veprimet ligjore ndaj pjesës së saj të padisë, pavarësisht bashkëndërgjyqësve të tjerë.
24. Andaj, konsiderojmë se në rastin konkret, vendimtare për të përcaktuar vlerën e kontestit sipas revizionit nuk ishte neni 32 i LPK-së pasi ky nen ndërlihdhet me vlerën e përgjithshme të kontestit me rastin e paraqitjes së padisë dhe jo me vlerën e goditur përmes revizionit, siç përcaktohej me nenin 211 të LPK-së. Kontestuese ishte nëse në rastin konkret aplikoheshin dispozitat e nenit 268 të LPK-së sa i përket bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë apo dispozitat e nenit 269 të LPK-së sa i përket bashkëndërgjyqësisë unike. Andaj, duke qenë se secila palë në procedurë ishte palë në vete, lidhur me të cilën ishte përcaktuar ndaras shuma e kompensimit nga Gjykata e Apelit, dhe se kontesti jo domosdoshmërisht do të duhej të zgjidhej në mënyrë të njëjtë

për të gjitha parashtrueset e kërkesës, pasi revizioni i njëjës palë nuk kishte pasoja edhe tek palët tjera, ashtu siç përcaktohet me nenin 269 të LPK-së. Andaj, në rastin konkret janë të aplikueshme dispozitat e nenit 268 të LPK-së, përkitazi me bashkëndërgjyqësinë e thjeshtë.

25. Andaj, në rrethanat e rastit konkret, konsiderojmë që vendimmarrja e Gjykatës Supreme nuk ka rezultuar në *“formalizëm të tepruar”*. Kjo për më tepër që Gjykata Supreme përkitazi me llogaritjen e vlerës së goditur me revizion, kur kemi të bëjmë me bashkëndërgjyqësi të thjeshtë, rezulton të ketë një praktikë koherente gjyqësore dhe të cilën e zbaton në mënyrë të qëndrueshme.
26. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, dhe me respekt ndaj Shumicës, konsiderojmë se Aktvendimi [Rev.nr.216/2023] i 19 qershorit 2023, i Gjykatës Supreme është dashtë të konstatohet se nuk është në kundërshtim me nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Dorëzuar me respekt nga Gjyqtarët:

Remzije Istrefi –Peci



Enver Peci

Jeton Bytyqi